



## Çfarë do të thotë për ju ndalimi i hyrjes?

Ju u është shpallur ndalimi i hyrjes. Vendimi që keni marrë thotë se përse ju u është shpallur ndalimi i hyrjes. Në këtë broshurë shpjegohet se çfarë është ndalimi i hyrjes dhe çfarë do të thotë kjo për ju.

1. Çfarë është ndalimi i hyrjes dhe për cilat shtete(vende) zbatohet?
2. Sa zgjat ndalimi i hyrjes dhe kur do të përfundoj?
3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në sistemin e informacionit Shengen (SIS)?
4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga SIS?
5. Çfarë ndodh nëse ju prap se prap do jeni në Holandë?
6. Çfarë mund të bëni nëse nuk pajtoheni me ndalimin e hyrjes?
7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?
8. Si të kërkonti shfuqizimin e ndalimit të hyrjes?
9. Çfarë ju të bëni nëse keni pyetje?

### 1. Çfarë është ndalimi i hyrjes dhe për cilat shtete(vende) zbatohet?

Nuk ju lejohet të udhëtoni dhe të jeni në shtetet (vendet) e Bashkimit Evropian (BE), të zonës Ekonomike Evropiane dhe në Zvicër për një periudhë të caktuar kohore. Lexo në [www.ind.nl/eueer](http://www.ind.nl/eueer) dhe [www.ind.nl/en/eueea](http://www.ind.nl/en/eueea) cilat janë shtetet (vendet) e BE/ZEE. Ne i referohemi tutje të gjitha këtyre vendeve si BE. Ndalimi i hyrjes nuk vlen për Irlandën.

Ju do merrni një ndalim hyrje vetëm pas një vendimi për kthim. Ky është një vendim që thotë se ju nuk ju lejohet të jeni në Holandë dhe se duhet të largoheni nga BE. Dhe ju duhet të ktheheni në shtetin (vendin) që thuhet në vendimin e kthimit. Ose në një shtet (vend) tjetër jashtë BE-së (pa Irlandë) ku ju lejohet të qëndroni.

### 2. Sa zgjat ndalimi i hyrjes dhe kur do të përfundoj?

Varet nga situata juaj se sa vjet zgjat ndalimi i hyrjes. Në vendimin që keni marrë tregon se sa do të zgjasë ndalimi i hyrjes për ju.

Kohëzgjatja e ndalimit tuaj të hyrjes fillon në datën kur ju largoheni nga BE. Kur IND e dinë që ju jeni larguar nga BE? Atëherë ndalimi juaj i hyrjes do të përfundoj kur të ketë përfunduar periudha e ndalimit të hyrjes. Në këtë rast, sinjalizimi do të hiqet nga SIS dhe më pas mund të udhëtoni përsëri në Holandë dhe në vendet tjera të BE-së. Lexoni në pytjen 3 se çfarë është sinjalizimi dhe SIS.

### 3. Çfarë do të thotë sinjalizimi në sistemin e informacionit Shengen (SIS)?

Ju do jeni sinjalizuar për ndalimin e hyrjes. Të jesh i sinjalizuar ose sinjalizimi do të thotë që autoritetet e vendosin emrin tuaj në sistemin e informacionit Shengen(SIS) të BE-së. Rojet kufitare dhe policia e vendeve Shengen shohin përmes sinjalizimit tuaj në SIS se ju keni një ndalim hyrje. Pas kontrolës ata mund t'ju ndalojnë. Në atë rast nuk do të lejoheni të hyni në vend. Ju mund të lexoni se cilat shtete (vende) janë shtete (vende) Shengen në, [www.ind.nl/schengengebied](http://www.ind.nl/schengengebied) ose [www.ind.nl/schengenarea](http://www.ind.nl/schengenarea).

#### *Së pari sinjalizimi për vendimin për kthim*

Sinjalizimi për ndalimin e hyrjes nuk ndodh menjëherë. Fillimisht do të regjistroheni në SIS për vendimin e kthimit. A jeni larguar nga BE dhe a është IND në dijeni për këtë? Pastaj sinjalizimi juaj do të ndryshojë në një sinjalizim për ndalimin e hyrjes. Ju nuk ju lejohet më të udhëtoni në BE dhe nuk mund të jeni në BE. Lexoni më shumë rreth sinjalizimit dhe vendimit të kthimit në [www.ind.nl/nl/terugkeerbesluit](http://www.ind.nl/nl/terugkeerbesluit) ose [www.ind.nl/en/return-decision](http://www.ind.nl/en/return-decision).

#### *E drejta e qëndrimit në BE dhe ndalimi i hyrjes nga Holanda*

A keni tashmë të drejtën e qëndrimit në një shtet (vend) të BE-së dhe nëse ju kanë vendosur autoritetet Holandeze një ndalim hyrjeje? Atëherë do të sinjalizoheni në SIS vetëm nëse shteti i BE-së tërheq të drejtën tuaj të qëndrimit. Atëherë autoritetet mund të vendosin një masë tjetër. Ju do të sinjalizoheni për këtë në sistemin e informacionit Holandez Executiv & Signalering (E&S). Vetëm policia dhe policia Mbretërore e Holandës mund të kontrolloj E&S.

#### **4. Kur do të hiqen të dhënat tuaja nga SIS?**

- Nëse është e sigurt se kohëzgjatja e ndalimit të hyrjes ka skaduar.
- Nëse IND e di që ju u është dhënë e drejta e qëndrimit në një vend të BE-së pas ndalimit tuaj të hyrjes. Më pas IND do të heqë ndalimin tuaj të hyrjes dhe do të heqë sinjalizimin tuaj nga SIS. Nëse ju jeni një kërcnim për rendin publik, autoritetet mund të vendosin një masë tjetër ndaj jush. Ju do të sinjalizoheni për këtë në sistemin e informacionit Holandez E&S.
- Ju keni kërkuar që të shfuqizohet ndalimi juaj i hyrjes dhe kjo kërkesë është miratuar. Pyetja 8 shpjegon se si të kërkohet shfuqizimin. Nëse ju do të merrni një shfuqizim të përkohshme të ndalimit tuaj të hyrjes? Atëherë sinjalizimi juaj do mbetet në SIS.

#### **5. Çfarë ndodhë nëse ju jeni prap se prap në Holandë?**

Udhëtimi në Holandë dhe qëndrimi në Holandë është i dënueshëm. Mund të marrësh një dënim me burg deri në 6 muaj maksimalisht ose një gjobë prej disa mijra Euro. Kjo ceket në nenin 197 të kodit penal dhe nenin 108 të ligjit për të huajt.

#### **6. Çfarë mund të bëni nëse nuk jeni i pajtimit me ndalimin e hyrjes?**

Kjo varet nga situata juaj. Ju mund të bëni një ankimim tek IND ose të apelonit në gjykatë. Në vendim tregohet se si mund ta bëni këtë.

#### **7. Kur mund të udhëtoni ju përsëri në Holandë?**

- Nëse është e sigurt se kohëzgjatja e ndalimit të hyrjes ka skaduar.
- Ju keni kërkuar shfuqizimin (të përkohshme) të ndalimit të hyrjes dhe kjo kërkesë u është miratuar.

#### **8. Si të kërkonte shfuqizimin e ndalimit të hyrjes?**

Ju mund të kërkonte shfuqizimin (të përkohshme) të ndalimit të hyrjes. Për shembull, sepse duhet të jeni në Holandë përpara se të skadojë ndalimi juaj i hyrjes. Ose sepse IND nuk e di se ju jeni larguar nga BE. Për këtë mund të përdorni formularin e *kërkesës për të shfuqizuar një deklaratë të padëshirueshmërisë ose ndalim të hyrjes* (9004 of 9504) në faqen e internetit për këtë qëllim, të plotësoni dhe ta dërgoni në IND. Ose ju dërgoni një letër në IND me një shpjegim në të cilën ju kërkonte që ajo të shfuqizohet. Gjithashtu dikush tjetër mund të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj. Ju duhet të i jepni atij personi lejen zyrtare për të ndërmarrë veprime në emrin tuaj. Ju e vendosni këtë në letër me nënshkrimin tuaj. Kjo quhet autorizim. Bashkëngjit autorizimin me aplikacionin për shfuqizimin e ndalimit të hyrjes.

Dërgoni formularin ose letrën tek:

IND Titel en Identiteit  
Postbus 10  
9560 AA Ter Apel

#### *Kushtet për shfuqizimin e ndalimit të hyrjes*

IND mund (përkohësisht) të shfuqizoj ndalimin e hyrjes nëse plotësoni një nga kushtet e mëposhtme:

- Shfuqizimi është e domosdoshëme në situatën tuaj.
- Vetëm me një ndalim hyrje prej 2 vjetësh ose më pak:
  - Ju tashmë jeni larguar nga BE për gjysmën e kohëzgjatjes së ndalimit të hyrjes ose më shumë rresht/pandërprerë.
  - Ju nuk keni kryer ndonjë krim të rëndë gjatë periudhës që jeni larguar nga Holanda.
  - Ju në këtë moment nuk jeni duke u ndjekur penalisht për ndonjë vepër penale.

#### *Dokumentet që shfuqizojn ndalimin e hyrjes*

Dërgoni së bashku me formularin ose letrën edhe informacionet dhe dokumentet e mëposhtme :

- Një shpjegim se pse shfuqizimi i ndalimit të hyrjes është e domosdoshme në situatën tuaj.
- Të dhënat tuaja personale të plota dhe emrat e tjerë (pseudonimet) që keni përdorur më parë
- Kopje të të gjitha faqeve të të gjitha pasaportave tuaja që keni pasur që nga ndalimi juaj i hyrjes. Ose dokumente të tjera me të cilat mund të udhëtosh dhe të kalojnë kufirin.
- Një pasqyrë dhe dëshmi të shteteve dhe vendeve ku keni qenë pas ndalimit tuaj të hyrjes. Me këtë tregoni se ju jeni jashtë BE-së gjatë aplikimit për shfuqizimin.
- Dokumente zyrtare nga autoritetet e çdo shteti ku keni qenë pas ndalimit të hyrjes. Kjo duhet të tregojë se ju nuk keni kryer ndonjë krim të rëndë në atë vend. Dhe se ju aktualisht nuk ndiqeni penalisht për asnjë vepër penale në shtet.
- Nëse duhet të jesh përkohësisht në Holandë? Atëherë dërgoni gjithashtu edhe informacionin e mëposhtëm:
  - Data e mbërritjes tuaj në Holandë dhe vendin ku do hyni në Holandë.
  - Numrat e fluturimit të fluturimit të ardhjes- dhe kthimit.
  - Një pasqyrë e të gjitha vendeve ku do të qëndroni në Holandë. Dhe dëshmi që ofrojnë siguri për qëndrimin tuaj dhe kostot e qëndrimit.
  - Në rast të një çështjeje penale: informacione për statusin dhe ecurinë e çështjes penale.
- Nëse ju autorizoni dikë tjetër që të kërkojë shfuqizimin në emrin tuaj: një autorizim me nënshkrimin tuaj.

Dokumentet zyrtare të huaja bëri të legalizuara dhe të përkthyer në Holandisht, Anglisht, Frëngjisht ose Gjermanisht.. Lexoni informacione rreth legalizimit dhe përkthimit në [www.ind.nl/legalisatie-vertaling](http://www.ind.nl/legalisatie-vertaling) ose [www.ind.nl/legalisation-translation](http://www.ind.nl/legalisation-translation).

#### **9. Çfarë të bëni nëse keni pyetje?**

- Vizitoni faqen tonë të internetit në [www.ind.nl/inreisverbod](http://www.ind.nl/inreisverbod) ose [www.ind.nl/en/entry-ban](http://www.ind.nl/en/entry-ban).
- Telefononi linjën e informacionit të IND në +31 88 043 04 30. Ky numër mund të arrihet nga e hëna deri të premten nga ora 09.00 deri në ora 17.00.

*Asnjë e drejtë nuk mund të rrjedhë nga përmbajtja e publikimit. Nëse përkthimi çon në dallime në interpretim, versioni Holandez do të mbizotërojë. Teksti nga ky botim mund të përdoret me kusht që të përmendet burimi.*